



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E KULTURËS  
KËSHILLI KOMBËTAR I RESTAURIMEVE

**VENDIM**

**Nr. 121 dt. 11.12.2014**

Në mbështetje të nenit 17, të ligjit nr. 9048, datë 07.04.2003, “Për Trashëgiminë Kulturore”, i ndryshuar. Këshilli Kombëtar i Restaurimeve, në mbledhjen e datës 11.12.2014, pasi shqyrtoi projektin e diskutuar më parë në Këshillin Shkencor të Institutit të Monumenteve të Kulturës,

**VENDOSI:**

1. Miratimin e projektit “Përgatitja e projektit dhe dosjes së tenderit në lidhje me punimet e Restaurimit në qytetet e Trashëgimisë Historike, Vendodhja –Elbasan, Berat, Vlorë, Burrel, Krujë dhe Shkodër”. (Faza e Dytë - projekt-zbatimi)“ me këto kushte për qytetet:
  - Elbasan:
  - Të mos realizohet rrethimi i propozuar i rrënojave të Bazilikës në projektin e zbatimit.
  - Të vendosen tabela informuese dhe edukuese përgjatë perimetrit të rrethimit ekzistues.
  - Berat:
  - Miratohet varianti sistemimit të terrenit me mobilim me stol rrethor në hyrjen e Belvederes, me veshje me gurë.
  - Kanalinat për ndriçuesit me braçeta të vendosen sipas tre varianteve ( e fshehur, vertikal apo horizontal) sipas gjykimit rast pas rastit nga supervizori, gjatë zbatimit të punimeve.
2. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Inventarizimit të Pasurisë Kulturore për regjistrimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Sekretaria Teknike për njoftimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KRYETAR**

**MIRELA KUMBARO FURXHI**

**SEKRETAR I KKR**

**ARTA DOLLANI**